

LIGJ
Nr.7547, datë 6.1.1992

PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Akcizat janë tatime mbi një numër të kufizuar mallrash për konsum të brendshëm, pavarësisht nëse prodhohen brenda vendit apo importohen.

Neni 2

Personat juridikë dhe fizikë që i nënshtrohen këtij tatimi janë prodhuesit dhe importuesit e mallrave të tatueshme me akcizë.

Neni 3

Mallrat që tatohen me akciza dhe përqindjet e tyre janë:

a) Prodhime duhani: Përqindja e akcizës

- Cigare.....	75
- Puro.....	75
- Duhan llulle.....	75

b) Pije alkoolike Përqindja e akcizës

- Birrë.....	30
- Verë.....	35
- Raki.....	50
- Konjak, uzo, fërnjet, ponç, uiski, rum dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike.....	80
- Likernat.....	50

c) Nënproduktet e naftës me
përshtim të vajgurit që
konsumohet nga popullata 50

Neni 4

Për mallrat që prodhohen brenda vendit, akcizat llogariten në bazë të vlerës së çdo sasive malli të shitur me çmimet korente.

Neni 5

Për mallrat që importohen, akcizat llogariten në bazë të vlerës të doganuar, duke shtuar edhe shumën e taksës doganore.

Neni 6

Për mallrat që prodhohen brenda vendit, detyrimi për pagimin e akcizave fillon nga koha kur malli shkon për konsum të brendshëm.

Neni 7

Për mallrat e importuara pagimi i akcizave bëhet njëherësh me pagimin e taksës doganore.

Neni 8

Për mallrat e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, kur kalojnë për eksport, nuk zbatohen akcizat.

Neni 9

Akcizat derdhen në buxhetin e shtetit. Prodhuesit dhe importuesit detyrohen të llogaritin dhe të derdhin në buxhet akcizat çdo 10 ditë.

Neni 10

Ministria e Financave ka të drejtë të caktojë afate të detajuara për pagimin e akcizave.

Neni 11

Prodhuesit dhe importuesit e mallrave që tatohen me akcizat, detyrohen të mbajnë llogari të veçantë, të plotësojnë dhe të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore për akcizat e realizuara, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Ministria e Financave.

Neni 12

Konsiderohen shkelje të këtij ligji:

- Fshehja e falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e akcizave;
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël për akcizat;
- Derdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit;
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara.

Neni 13

Shkeljet e parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, dënohen edhe me këto masa:

- Fshehja dhe falsifikimi i akcizave, me gjobë në masën 5- fish të shumës së akcizës të fshehur ose të falsifikuar dhe me marrjen 100 për qind të akcizës të fshehur ose të falsifikuar;
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël, me gjobë nga 1000 deri në 4000 lekë;
- Derdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit, me gjobë 1000 lekë dhe me kamatë vonesë në masën 1,20 për qind për çdo ditë vonesë;
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara, me gjobë 1000 deri në 4000 lekë.

Neni 14

Të drejtën e vendosjes së gjobave dhe arkëtimin e kamatë- vonesave e kanë inspektorët e tatimeve në rreth dhe punonjësit e drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të dënimit, përkatësisht te përgjegjësi i seksionit të financës a të drejtori i drejtorisë së tatimeve, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 15

Akcizat nuk zbatohen për mallrat, ndaj të cilave me ligj të veçantë zbatohet tatimi mbi qarkullimin e mallrave.

Neni 16

Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 17

Dispozitat që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992.

Shpallur me dekretin nr.110, datë 11.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.